



## **BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**

Në mbështetje të nenit 47, paragrafi (1), pika 6) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14 dhe 153/15 ) dhe neni 2, paragrafi (1), pika 29) dhe nenin 64, paragrafi (3) nga Ligji i Bankave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/07, 90/09, 67/10, 26/13, 15/15 dhe 153/15), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, miratoi

### **VENDIM**

#### **për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për metodologjinë e përcaktimit të përshtatshmërisë së kapitalit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 223/15)**

1. Në Vendimin për metodologjinë e përcaktimit të përshtatshmërisë së kapitalit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 47/12, 50/13 dhe 71/14), në pikën 6), pas nënpikës 19), shtohet nënpikë e re 19-a) që vijon:

19-a) Hapësirë afariste është çdo objekt të destinuar për kryerjen e aktivitetit të caktuar afariste ose komerciale, me përjashtim të fabrikave dhe kapacitete tjera të ngjashme prodhimi dhe toka bujqësore. Toka ndërtimore konsiderohet për hapësirë afariste, nëse është destinuar për ndërtim të hapësirës afariste dhe është siguruar leje përkatëse për ndërtim. Garazhi ose vendi për parkim ose oborri konsiderohen për hapësirë afariste, nëse mbi to është vendosur hipoteka, së bashku me hapësirën afariste. Pajisja në hapësirën afariste konsiderohet për hapësirë afariste, nëse mbi të është vendosur hipoteka, së bashku me hapësirën afariste, me përjashtim të pajisjes së zyrës, kompjuterëve, mobiljeve dhe pajisja tjetër e ngjashme."

2. Në pikën 38), paragrafi (4), nënparagrafi (3) ndryshohet dhe thotë:

"-detyrimet e ndërmarra jashtë bilancit në bazë të garancive të performancës dhe garancive për pjesëmarrje të tenderit (duke përfshirë edhe garancitë lidhur me këto garanci, siç janë garancitë për kthim avans) dhe të gjitha garancitë me të cilat garantohet ekzekutim i caktuar, gjegjësisht me të cilat nuk garantohet plotësimi detyrim i caktuar kreditor nga debitori".

Në paragrafin (5), nënparagrafi (2) fjalët: "tjera të ngjashme", zëvendësohen me fjalët: "transportuese/tranzit".

Në paragrafin (5), nënparagrafi (3) ndryshohet dhe thotë:

"-detyrimet e ndërmarra jashtë bilancit (akreditive dhe garanci të pambuluara) për pagesë në rast të mosplotësimit të detyrimeve të debitorit për pagesë ndaj palës së tretë që rezultojnë nga marrëdhënia e caktuar afariste, me përjashtim të garancive me të cilat garantohet marrëdhënia e kredisë,"

Në paragrafin (6), nënparagrafi (1) ndryshohet dhe thotë:

"-garanci të pambuluara (që nuk janë të përfshira në shkallët e mëparshme të rrezikut) me të cilat garantohet plotësimi i detyrimit të caktuar kreditor nga debitori,".

Në paragrafin (6), në nënparagrafi (6) pas fjalës: "detyrime", shtohen fjalët: "për kreditim".

3. Në pikën 42), pas paragrafit (1), shtohet paragrafi i ri (2) që thotë:

"Në kërkesat për të cilat Banka Popullore ka konstatuar se banka i ka ndarë në mënyrë të papërshtatshme në ponder më të ulët të rrezikut, gjegjësisht faktor më të ulët të konvertimit, banka është e detyruar në dy vitet e ardhshme ta zbatojë ponderin e rrezikut, gjegjësisht faktori i konvertimit që është dashur ta zbatojë në pajtim me dispozitat e këtij vendimi, pavarësisht nëse gjatë këtyre dy viteve janë plotësuar kushtet për zbatimin e ponderit më të ulët të rrezikut, gjegjësisht faktorit të konvertimit, përveç nëse Banka Popullore gjatë këtyre dy viteve ka përcaktuar se janë plotësuar kushtet për zbatimin e ponderit më të ulët të rrezikut, gjegjësisht faktori i konvertimit."

4. Në pikën 66), pas paragrafit (3) shtohet paragrafi i ri (4) që thotë:

"Me përjashtim të paragrafëve (1) dhe (2) të kësaj pike, banka është e detyruar të zbatojë ponder të rrezikut prej 150% të kërkesave në bazë të kredive konsumatore me afat kontraktual të maturimit që është i barabartë ose më i gjatë se tetë vjet."

5. Pas pikës 66), shtohet pikë e re 66-a) që bëhet:

"66-a.) Banka është e detyruar të zbatojë ponder të rrezikut prej 75% të diferencës pozitive ndërmjet:

- ekspozimi total në bazë të mbitërheqjeve të lejuara të xhirollogarive (bilancet negative të llogarive rrjedhëse) edhe të kartelave kreditore të lëshuara të datës për të cilën raportohet, dhe
- ekspozimi total në bazë të mbitërheqjeve të lejuara të xhirollogarive (bilancet negative të llogarive rrjedhëse) dhe të kartelave kreditore të lëshuara më 31 dhjetor 2015.

Për nevojat e paragrafit (1) të kësaj pike, ekspozimi total në bazë të mbitërheqjeve të lejuara të xhirollogarive edhe të kartelave kreditore të lëshuara përcaktohet si përmbledhje e kërkesave të balanceve dhe jashtëbalanceve në bazë të mbitërheqjeve të lejuara të xhirollogarive dhe të kartelave kreditore të lëshuara, pa marrë parasysh faktorët e konvertimit dhe instrumentet për mbrojtje kreditore."

6. Në pikën 71), nënparagrafi 6) pas fjalës: "konvertim" shtohen fjalët: "edhe instrumentet për mbrojtje kreditore", dhe fjalët: "vlerën e tregut" zëvendësohen me fjalët: "vlera e tregut".

7. Në pikën (72), paragrafi (2) ndryshohet dhe thotë:

"Me përjashtim të paragrafit (1) të kësaj pike, banka mund të zbatojë ponder të rrezikut prej 75% të kërkesës të mbuluar me hapësirë afariste nëse:

- hapësira afariste përdoret për kryerjen e veprimtarisë së debitorit;
- vlera e hapësirës afariste nuk varet nga aftësia kreditore e debitorit, duke mos e marrë parasysh ndikimin që mund ta kenë faktorët makroekonomikë mbi vlerën e hapësirës afariste dhe mbi aftësinë kreditor të debitorit;
- shuma totale e kërkesës, pa u zvogëluar shuma e vlerës së korrigjimit të veçantë, gjegjësisht rezervës së veçantë dhe pa u korrigjuar për faktorët e konvertimit dhe instrumenteve për mbrojtje kreditore, nuk është më e madhe se 50% nga vlera e tregut të hapësirës afariste;
- në mënyrë të duhur janë plotësuar kriteret nga pika 71), nënparagrafët 4) dhe 5) të këtij vendimi."

8. Pika 4) e këtij vendimi do të zbatohet për kreditë konsumatore me afati kontraktual të maturimit të barabartë ose më të gjatë se tetë vjet të miratuara pas datës së zbatimit të këtij vendimi, duke përfshirë edhe kreditë konsumatore tek të cilat banka ka kryer rifinancim (me përjashtim të rifinancimit për shkak të shlyerjes së ekspozimit kreditor në bankë tjetër) ose ristrukturimin të bëra pas datës së zbatimit të këtij vendimi, me ç'rast afati total i maturimit të kredisë, i përcaktuar si përmbledhje e afatit kontraktual të maturimit të datës së zbatuar të këtij vendimi dhe për të gjitha vazhdimet e afatit të maturimit të kredisë, është e barabartë ose më e gjatë se tetë vjet.

9. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Veriut, dhe do të fillojë të zbatohet nga 1 janari 2016.

**V nr. 02-15/XVI-3/2015**  
**17 dhjetor 2015**  
**Shkup**

**Guvernatori**  
**dhe kryesuesi**  
**i Këshillit të Bankës Popullore të**  
**Republikës së Maqedonisë**  
**Димитар Богов**